



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 Nr. 08/21
Rahovec, 23.08.2021

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më 31 gusht 2021 (e martë) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.276/2009, të datës 02.07.2010.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2021;
5. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në komunën e Rahovecit;





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.07.2021, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. Fatmir Iska, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm! Para se me fillua me mbledhjen e rregullt të Kuvendit, në shenjë nderimi për bashkatdhetarët tanë të cilët humbën jetën tragjikisht me 25 korrik në Kroaci, ju ftoj që t'i nderojmë për një minutë heshtje. I përjetshëm kujtimi për mërgimtarët tanë!
Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar – Qershor 2021,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje qytetar nderi z. Qemal Minxhozi,
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të jashtëm të Komunës së Rahovecit për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2020,
6. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020 – 2021.

Të nderuar kolegë kuvendarë, meqenëse sot e kemi pike të rendit të ditës, shpalljen qytetar nderi të ambasadorit z. Qemal Minxhozi, që e kemi si pikë të katërt të rendit të ditës, atëherë kisha kërkuar nga ju mirëkuptimin tuaj që kjo pikë të jetë e fundit e rendit të ditës dhe ne të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës dhe në momentin që ambasadori të jetë prezent me neve në këtë sallë në orën 11:30 nga komunikimi dhe informatat që kemi, kështu që ne duhet të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës dhe në momentin që ambasadori vjen atëherë shkojmë tek pika për shpalljen qytetar nderi të ambasadorit z. Qemal Minxhozi.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Unë pajtohem me pikat e rendit të ditës, përjashtim kam një vërejtje për pikën e gjashtë të rendit të ditës që nuk është e emërtuar mirë Shqyrtimi i raportit të DKA-së në përfundimin e vitit mësimor 2020-2021, sepse viti shkollor duhet të përfundon me 31 gusht dhe po ashtu kjo nuk është raport por thjesht një informatë. Pra do të ishte mirë me quajt informatë e jo raport pasi është një fletë aty që i ka disa të dhëna shumë të mira por raporti është krejt diçka tjetër pasi që paraqet numrin e nxënësve pastaj kemi tabelore pastaj numrin e paraleleve, pra këtu është vërejtja ime.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, atëherë e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovet rendi i ditës. Kalojmë n pikën e pare te rendit te ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovet procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë ne pikën e dyte te rendit te ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendarëve.

Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar sa i përket pikës se dytë, kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar – Qershor 2021.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtare te kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm.

Raporti 6-mujor financiar i komunës se Rahovecit është plotësisht i përputhur me departamentin e buxhetit te ministrisë dhe financave, kështu që ky raport përbehet nga 3 pjesë: pjesa e te hyrave, pjesa e shpenzimit te buxhetit dhe pjesa e aktiviteteve te prokurimit. Paraprakisht ju them se ne kuadër te këtij raporti janë te përfshira te gjitha ngjarjet dhe aktivitetet te cilët janë zhvilluar ne këtë periudhe 6 mujore. Paraprakisht ju njoftoj se deri ne këtë date te raportimit ende nuk e kemi një raport nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut për 3 mujorin e tretë te këtij 6 mujori pra nga prilli deri ne qershor. Te hyrat e rregullta gjate kësaj periudhe ne total kanë qenë prej 146,840 euro dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë te vitit te kaluar atëherë shohim se kemi një ndryshim pozitiv ne rrije me vlerë 146,840 euro dhe ne përqindje ne raport me vitin e kaluar kemi 30.60%. Kur i fusim edhe te hyrat nga gjobat e gjykatave dhe trafikut atëherë e shohim se kemi një inkasim me vlere prej 625,383 që do te thotë se diferenca është pozitive me vlere prej 146,840 euro. Tash realisht kur e bëjmë këtë krahasimin është i njëjtë me periudhën e vitit te kaluar sepse për kundër asaj që vitin e kaluar kemi qenë ne kohe pandemie dhe për dy muaj nuk kemi pasur inkasim, mirëpo ne raport duke shikuar inkasimin ne muajin korrik e shohim që për afërsisht trendi i inkasimit te hyrave është i njëjte. Shpenzimi i buxhetit për këtë periudhe konsideroj që është ne mënyre te kënaqshme ku me përqindje buxheti është shpenzuar rreth 53,40% apo ne total shpenzimi i buxhetit ne te gjitha kategoritë është prej 7,592,140 euro. Në kuadër te këtij raporti kemi edhe shpenzimi i buxhetit sipas shpenzimeve komunalit dhe gjithashtu e kemi te paraqitur ne raport edhe kategorinë e mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive ekonomike që ne detaje janë te paraqitura te gjitha shpenzimet dhe krejt ne fund e kemi aktivitetet e prokurimit te cilat janë zhvillua deri me 30 qershor për te gjitha kontrata që janë te lidhura deri me atë periudhe. Kështu që nuk kam diçka për te shtuar rreth raportit dhe pres nga ju ndonjë pyetje.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për sjelljen e raportit 6-mujor te këtij viti dhe prezantimin e tij dhe po ashtu është shume e vërtet se te hyrat për këtë vit kanë shënuar progres pra kemi ngritje, kështu që unë do te ndalem te krahasimi i të hyrave te rregullta te realizuara ne baza mujore te tabela 1.3 deshta që drejtori me na dhanë pak sqarime p.sh. gjate muajit mars prill maj kemi ndryshime p.sh. ne mars për vitin 2020 realizimi ka qenë 80,323 euro ndërsa për këtë vite 2021 është 16,898 euro d.m.th. shume pak kështu që me na tregua se pse është ky ndryshim kaq pak te hyrat e rregullta, pasta ne muajin prill është e kundërta, pasi ka qenë pak ne vitin 2020 ndërsa për vitin 2021 është mirë pasi është 107|245 euro pra ka shënuar progres edhe ne muajin Maj për vitin 2020 ka qenë 27,181 ndërsa tash për vitin 2021 është prape mirë pasi është 81,201 euro, pra me na dhanë sqarime rreth këtyre vlerave se posë deri ka ardh deri te kjo. Pastaj ne faqe tjetër te gjobat ne trafik dhe gjobat nga gjykatat është ne rregull pasi drejtori e dha sqarimin pasi ne këto 3 muajt e fundit edhe nga gjobat e trafikut edhe nga gjobat e gjykatave nuk kemi te hyra pasi nuk janë te evidentuara por sidoqoftë pe shoh se te gjobat e gjykatave gati që me 3 muaj e kemi arrit shumen e vitit te kaluar edhe sigurisht se kur do ti shtohen edhe këta 3 muaj atëherë me siguri se do te jetë me mirë. Po ashtu drejtor disa here e kam përsëritur që duhet te ju shtoni titujve me shume rendësi pasi ky është dokument, ku shkruan gjobat nga „e trafikut,“, pra do te ishte mirë që eliminohen këto gabime dhe te shkruhet ashtu si duhet gjobat nga trafiku apo gjobat e trafikut. Tek te hyrat e rregullta ne përgjithësi e konstatoam se ka rritje dhe nuk kemi pse me vazhdua me tepër. Pastaj do te ndalem tek tabela 1.6 krahasimi i te hyrave te realizuara sipas kodeve ekonomike 2021-2020, ne shtyllën e pare ku shkruan planifikimi për vitin 2021, tash shtrohet pyetja që ky planifikim a është për raport 6 mujor apo për tere vitin, dhe ndoshta do te ishte mirë që me ndaje se sa ka

qenë planifikimi për 6 mujor që me qenë e ndarë e me pastaj e dimë krahasimin e realizimit se sa u bë për këtë 6 mujor për vitin 2021. Pastaj tek disa kode kemi ndryshime të mëdha mes planifikimit dhe realizimit për periudhën Janar qershor dhe tash nuk e di pse ka ndodh kjo por shembull mund ta marrim kodin 50409 participimet në bujqësi ku kemi të planifikimin 80,000 euro që është bërë ndërsa realizimi për këtë 6 mujor është 15,277 euro d.m.th. në njëfarë mënyre nuk po shkon me planifikimin ashtu si duhet apo planifikimi nuk ka qenë i mirë apo realizimi nuk është bërë në bazë të planifikimit përafërsisht sepse asnjëherë nuk mund të përputhen planifikimi me realizimin. Po ashtu kemi edhe kode tjera si kodi 50026 taksa për legalizimin e objekteve që gjithashtu edhe në këtë kodë janë të planifikuara për vitin 2021 gjithsej 28,000 euro ndërsa janë realizuar 4813 euro në këtë 6 mujorë, kështu që kisha kërkuar sqarime se pse ka ardh deri të mosrealizimi i këtyre kodeve në bazë të planifikimit përafërsisht gjithsesi. Sa i përket raportit të buxhetit ku kemi alokim shpenzim sipas kategorive ekonomike mendoj që këtu shpenzimi i buxhetit ka shkue mirë pra nuk kemi ndonjë vërejtje rreth kësaj. Tek mallrat dhe shërbimet sipas kodeve ekonomike, në baze të analizave që i kemi bërë shihet se kemi rritje të shpenzimeve në këtë periudhë rreth 170,000 euro me shumë krahasuar me vitin 2020. Pastaj në faqe 14-të shërbime komunale, edhe këtu kemi rritje të shpenzimeve me shumë për 33,370 euro krahasuar me vitin 2020, pra do të ishte mirë që edhe për këto me na dhanë sqarime dhe krejt në fund të titulli i aktivitetit të prokurimit që pata një pyetje, kur e kemi miratuar buxhetin nuk me kujtohet saktësisht se sa mjete kanë qenë të parapara të ndara për shërbime konsulentë, ngase këtu siç po e shoh unë për shërbime konsulentë është një shumë prej 118,800 euro që janë shpenzuar për shërbime konsulentë dhe do të ishte mirë me na tregua që buxhetin kur e kemi miratuar që sa mjete kanë qenë të ndara sepse tani e shoh se një shumë goxha e madhe është shpenzuar për këto shërbime.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë dhe e falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për periudhën Janar – qershor 202. Unë do të ndalem tek faqe 9,10,11 dhe 12 tek mallrat dhe shërbimet sipas programeve, pasi që nëse krahasojmë periudhën 6 mujore të këtij viti me vitin 2020 atëherë e vërejmë që në disa drejtori kemi rritje të shpenzimeve p.sh. tek drejtorja e shërbimeve publike në vitin 2020 ka shpenzuar 106,291 euro ndërsa në vitin 2021 ka shpenzuar 160,163 euro që i bie 54,371 euro me shumë se në vitin paraprak, pastaj në shëndetësi dhe mirëqenie sociale për vitin 2020 shpenzimet kanë qenë 129,136 euro ndërsa për vitin 2021 shpenzimet kanë qenë 202,866 euro apo 37,730 euro me shumë se vitin paraprak, po ashtu edhe nde drejtorin e arsimit këtë vit shpenzimet janë 70,327 euro me shumë se që ishin në vitin 2020, kështu që kërkoj sqarime për këto ndryshime dhe për fund këtij raporti i mungon raportimi për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë e falënderoj drejtorin për financa që na ka ofruar këtë raport financiar për periudhën 6 mujore janar-qershor 2021, mendoj se raporti është i qartë dhe i ka tabelat krahasuese për vitin e kaluar që na bën neve me lehtë ta kuptojmë rrjedhën e buxhetimit, shpenzimeve e të hyrave, ashtu sikur se u tha edhe nga parafolësit e po ashtu edhe nga drejtori në shohim këtu se të hyrat për këtë periudhë për 6 muajt e parë në raport me vitin e kaluar ka rritje pra bilanc pozitiv edhe në raport me planifikimin e që është diçka e mirë dhe sigurisht se i gëzohemi kësaj. Tek të hyrat nga gjykatat dhe gjambat edhe parafolësit edhe drejtori e sqaroj se nuk kemi shënime për 3 mujorin e dytë, kështu që po del se ka më pak në krahasim se vitin e kaluar por besoj që me ardhjen e tyre pra me buxhetimin që shënojnë të hyra për këto 3 muajt atëherë besoj që do të jetë bilanci më i mirë. Kur jemi tek rritja e të hyrave për këtë vit në raport me vitin e kaluar për këtë periudhë, dy gjëra duhet t'i cekim se e para vitin e kaluar ka qenë pandemia dhe ka qenë e kuptueshme se të hyrat kanë qenë më pak e sidomos bie në sy muaji prill edhe maj që ka qenë vërtet koha e izolimit dhe sigurisht se ka qenë e kuptueshme për ne edhe tjetra është se ne e kemi cekur edhe me herët se edhe planifikimi në fakt ka qenë më i ulët, pasi që në gjithmonë kur e kemi diskutuar buxhetin kemi kërkuar që të hyrat vetanake, pra, planifikimi të jetë në limitet më të larta, pasi ka qenë një arsytim se ajo është nga niveli qendror për limitet apo tavanet që caktohen prandaj edhe bien në sy pastaj rritja e të hyrave. Po ashtu dua të bëj një ndërhyrje gjithashtu edhe në faqe 5 tek tabela 1.6 krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2021-2020, pasi këtë raport e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ku disa prej kodeve edhe nga parafolësit u tha që ka një diskrepancë të

madhe ne mes të planifikimit dhe të hyrave, ku u përmenden disa kode por unë do të përmendi diçka që nuk u përmend nga parafolësit kodi 50013 kodi për certifikata të lindjes ku planifikimi është 14,500, te hyrat janë 711 euro pastaj është eshë kodi 50026 taksa për legalizimin e objekteve gjithashtu planifikimi shume i lart kurse te hyrat shume te ultë, pastaj shfrytëzimi i pronës publike kodi 50405 që janë edhe disa kode tjerë, po ashtu e di që drejtori edhe në mbledhjen e kaluar ka dhënë pak a shume një sqarim p.sh. për një kodë pasi që ndonjëherë te hyrat për taksa shkojnë nga një kodë ne kodin tjetër mirëpo vërejtja jone e që është edhe kërkesa që kur te bëni planifikimin atëherë ju duhet me pas parasysh saktësisht se ku keni te hyra që me pas mundësi me i paraparë që mos të ketë diskrepancë kaq e madhe edhe me u shkaktua paqartësi. Tek shpenzimet buxhetore mendoj se ne përgjithësi shpenzimet kanë qenë te mira pra fondi buxhetor është shpenzuar ne mënyrë te kënaqshme rreth 53,40%, ne investimet kapitale aty edhe ku është me mirë të shfrytëzohen janë shfrytëzua mirë dhe po del rreth 64,39%, tek pagat dhe mëditjet për këtë periudhë keni shfrytëzuar rreth 50,95% pra janë shfrytëzua 1% me shume ne paga dhe mëditje ku ne vlerë me te holla është një vlerësim prej 72,690 euro më shumë kur e dimë se kjo kategori është fikse dhe nuk lejohen ndryshime këtu pasi është problem nëse shpenzohen me shume se sa që është planifikua, pasi shtrohet pyetja se nëse vazhdojnë shpenzimet me këtë trend atëherë deri ne fund te vitit kemi dyfishin e kësaj afër 150,000 euro se ku do ti merrni. Ne mbledhjen e KPF-se e keni dhënë një përgjigje dhe nuk e di sa është bindëse pasi për mua nuk është bindëse sepse keni thënë që ky shpenzim shtesë është për shkak te shtesave që janë dhënë ne arsim apo ne shëndetësi. Tash nuk jepen ato shtesa por çka nëse ato vazhdojnë me u dhanë sepse është ligji për rimëkëmbje dhe sipas ligjit ne shëndetësia presim që me na u dhanë ato shtesa, kështu që shtrohet pyetja se ku do ti merrni atë shume kur dihet se veç tash keni shpenzime me shume.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë raport qe e ka sjellë por meqenëse është raport 6 mujor, e kemi parasysh se dinamika e punimeve e shpenzimeve dhe pagesave është ne vazhdim e sipër dhe nuk mund te kemi një matës të sigurt për një performanc te saktë pa ardh raporti përfundimtar. Mirëpo ajo që me ra ne sy është ne faqe 15,që është një projekt që është zhvilluar ne 16 lote dhe besoj që kemi te bëjmë me kontratë me shërbime te veçanta dhe ajo që me bien ne sy është vlere e parashikimit përputhet saktë me vlerën e realizimit te kontratës. Zakonisht parashikimi duhet te jetë pak me i madhe se sa vlere e kontratës mirëpo ne këtë rast përputhet për cent dhe nëse ka mundësi drejtori me na dhanë një sqarim se si ka mundur kjo me ndodhë, për ndryshe janë raste te rralla kur parashikimi behet sakte, vetëm ne momentin kur e dimë sa përfundon kontrata e bën parashikimin saktë, kurse tash ne etapa dhe procedure parashikimi është i pari dhe realizimi është i fundit. Pra vetëm këtu kërkoj një sqarim.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, po filloj me pyetjen e parashtruar nga z. Rasim Fazliu i cili kërkoj një sqarim rreth krahasimit te te hyrave te rregullta dhe dallimit që ekziston prej vitit 2020 nga viti 2021 e posaçërisht për dy muajt. Vitin e kaluar e kemi kalua ne kohë pandemie dhe e dimë te gjithë se muajin prill dhe maj faktikisht nuk ka pasur fare te hyra dhe jeta ka qenë e paralizuar ndërsa nga muaji qershor ka fillua me u lirua paksa masat pasi pandemia ka fillua nga mesi i muajit mars por përsëri muaji marr ka qëndrua me mire ne krahasim me muajin prill dhe maj që nuk kemi pasur te hyra. Planifikimi është real brenda vitit 2021 nëse bëjmë krahasim me planifikim siç e thash edhe ne fillim se ne raport me planifikim atëherë inkasimi është përafërsisht i njëjte me periudhën e njëjtë te vitit te kaluar duke i përjashtuar muajin prill dhe maj, pasi e shohim se trendi i inkasimit që e kemi pae edhe për muajin qershor. Rreth gabimeve teknike është e pranueshme pasi janë ekzistente, pastaj pyetja tjetër rreth planifikimit ne faqe 5 tek shtylla e parë, e kemi qit planifikimin për 12 muaj ne shtyllën e pare ne mënyrë që kur te behet krahasimi ne përqindje, te behet një inkasim real që ne raport me përqindjen mundemi me pae se sa kemi pasur inkasim brenda këtij 6 mujori. Pastaj pyetja tjetër ishte ne raport me planifikimin, participimet ne bujqësi ka një inkasim shume te vogël deri ne këtë periudhe me arsyetim se deri me tash nuk kemi pas ndonjë thirrje për fermerë dhe pritet që tash e tutje do ta bëjmë atë edhe sigurisht se inkasimi do te rritet edhe ne këtë kategori ne raport me planifikimin që e kemi bërë. Gjithashtu edhe te taksat për legalizimin e objekteve, nëse ju kujtohet gjate hartimit te kornizës te planifikimit te buxhetit te vitit te kaluar, që kam marr një sugjerim nga asamblisti Fehmi Hoxha me ka premtua se do te kemi një inkasim te mirë dhe jam bazuar pikërisht me fjalën e Fehmi Hoxhes edhe pse deri

me tani nuk ka ndodhur por shpresojmë se deri ne fund do te kemi inkasim me te mirë. Pastaj pyetja tjetër e parashtruar ishte shpenzimi i buxhetit konkretisht te kategoria e mallrave dhe shërbimeve që kemi një rritje me te lartë, që është e vërtet që ne krahasim me vitin e kaluar kemi arrit me shpenzua buxhetin me mirë duke ditur se vitin e kaluar ka qenë një jetë e paralizuar edhe nëse bëjmë këtë krahasim atëherë normal që këtë vite kemi arrit me punua vazhdimisht ku te gjithë operatorët kanë punuar po ashtu te gjitha institucionet dhe normal që kemi pasur pagesa edhe është shpenzuar buxheti. Kjo pyetje i adresohet edhe Floridës, pasi ka pasur aktivite me shume dhe kjo është arsyeja që është shpenzuar buxheti. Por te dallimi te krahasimi, nuk mundemi gjithmonë me bo një krahasim te saktë p.sh. vitin e kaluar kemi një inkasim te madhe te shpenzimit te karburantit te ngrohjes qendrore ne raport me këtë vite sepse vitin e kaluar e kemi shfrytëzua çmimin e lirë që ka qenë ne treg dhe ne kemi arrit ne muajin prill me bo furnizimin me naftë dhe kjo është arsyeja se raporti ka dal ashtu sepse ka dallime ne krahasime, pra krejt kjo varet nga dinamika apo natyra e punës dhe aktiviteve që shfrytëzohen. Ne pyetjet e parashtruara nga asamblisti Fehmi Cena, edhe ne mbledhjen e KPF-së jemi sqaruar me doktorin rreth realizimit te hyrave konkretisht te taksa për certifikata te lindjes te cilët kanë një dallim por ne kemi një program softuerë që realisht te hyrat nga taksat e lindjes realizohen ne kuadër te kodit 50016 taksa për certifikata tjera ofiqarë, që do te thotë që te gjitha te hyrat që janë nga certifikatat e lindjes inkasohen ne këtë kodë ne taksa për certifikata tjera te ofiqarisë 14,133 euro. Pra për shkak te softuerit programit që është aty dhe ai i regjistron, kështu që shpresoj që kemi tentuar shume herë me shefin e IT-së me rregullua këtë problem mirëpo kjo ndërlihet edhe me nivele qendror dhe deri me tani nuk kemi mundur. Pastaj pyetje tjetër ishte edhe tek shpenzimi i buxhetit, që konsideroj që shpenzimi i buxhetit deri ne këtë periudhë është bërë ne mënyrë te kënaqshme dhe kemi bërë edhe krahasimin që është kategoria me e ndjeshme te investimet kapitale dhe investimet kapitale kanë një përqindje te mirë prej 64,39%. Pastaj pyetja tjetër ishte rreth mungesës se mjeteve ne pozicionin e pagave dhe ne këtë kategori qëndrojmë mirë dhe ne rapport me buxhetin që e kemi brenda këtyre 6 muajve d.m.th. buxheti është shpenzuar ne mënyrë reale dhe deri ne fund te vitit nuk do te kemi problem ne kuadër te kësaj kategorie sepse i kemi mjetet ne dispozicion edhe kështu që nuk do te kemi ndonjë problem. Nëse ju kujtohet ne raportin e parë 3 mujorë e kam potencuar që fillimi i vitit ministria e financave ka bërë një tërheqje ne pozicionin e pagave që i ka paguar punëtorët shëndetësor dhe te arsimit mirëpo me vonë e ka bërë kompensimin e atyre mjeteve dhe gjitha mjetet ne këtë kategori i kemi ne dispozicion. Pastaj pyetja e parashtruar nga asamblisti Munib Durguti, tek planifikimi me shpenzim te buxhetit te pozicioni për shërbime konsulentë ideale për nevojat e komunës se Rahovecit. Unë mendoj se këtu çdo gjë është e qartë pasi që vlera e parashikuar e kontratës është 3960 edhe çmimi i kontratës edhe shpenzimi është i njëjtë, pra paga mesatare për një punëtor konsulent është 300 euro dhe kur i shumëzojmë për një vite atëherë dele ajo vlerë kështu që çdo gjë është e qartë.

Rasim Fazliu – Drejtor faleminderit për te gjitha përgjigjet që na dhe por nëse ka mundësi edhe këtu për shërbime komunale kemi rritje te shpenzimeve për 33,370 euro edhe tek titulli i aktiviteve te prokurimit për shërbime konsulentë, sa mjete kanë qenë te parapara pasi e shoh këtu që 118,800 euro janë për këto shërbime konsulentë. Kështu që sa kanë qenë ne planifikim te parapara që me pas mundësi me ditë se a i kemi tejkaluar ato apo jemi ne shumen e njëjtë.

Afrim Limani – Për shërbime komunale kemi një diferencë te shpenzimeve ne këto kategori e sidomos ne rryme e po ashtu edhe ne ujë pastaj kemi edhe ne mbeturina. Mirëpo tani ne po prezantojmë një raport 6 mujorë pasi te gjitha ngjarjet aktivitetet që janë realizua brenda këtij 6 mujori janë te prezantuara ne këtë raport. P.sh. po supozojmë rrymën, operatori ekonomik ne këtë rast KED-si ka arritur që me kohë ti ofron te gjitha faturat shpenzimit deri ne atë periudhe edhe ne i kemi bërë shpenzimet. Por është realitet pasi çdo gjë po lidhet edhe me pandeminë pasi jeta ka qene e paralizuar edhe operatorët me kohe nuk i kanë ofrua faturat, kështu që ky është dallimi pasi që ne fund te vitit raporti ka me qenë përafërsisht i njëjtë sikur me vitet e tjera. Në këtë periudhe e kanë ngarkue ngase nga viti i kaluar e kemi bërë bartjen e borgjit me shume edhe mund te ndodhe edhe ky te jetë indikator. Për shërbime konsulentë tash çdo gjë është e qartë, pasi një punëtor paguhet 300 euro edhe aktualisht nuk e di sa punëtor i kemi, kështu planifikimi llogaritet numri i punëtove ne raport

brenda një viti dhe ai është planifikim dhe nëse për një punëtor paga mesatare është 300 euro atëherë nëse shumëzohet brenda një viti atëherë shumë është ajo .

Fehmi Hoxha – Faleminderit kryesues dhe përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Është shumë e vërtetë që unë kam kërkuar gjatë hartimit të buxhetit planifikim të të hyrave që të jenë edhe të hyra nga legalizimi i ndërtimeve pa leje, pasi e kam arsyetuar edhe atëherë që në bazë të regjistrimit që e kemi përfunduar që në atë kohë kam qenë edhe drejtor i urbanizimit 14,636 objekte në kuadër të territorit të komunës së Rahovecit që janë pa leje. Po ashtu në bazë të ligjit të vjetër ka qene e parapare të legalizohen objekte e jo pronat mirëpo në ndërkohë ligji tjetër është modifikuar edhe është nxjerr ligji i ri ku nuk mund të legalizohen objektet nëse nuk e ka pronarin nuk mund ta legalizoj nëse nuk e ka në pronësi në bazë të certifikatës. Kjo është një ngecje e madhe pasi është në tërë territorin e Kosovës e jo vetëm në komunën e Rahovecit. Pra kjo është përgjigja adekuate që u desht me dhanë ju z. Drejtor e jo që me keni besua pasi faktikisht po del që unë kam dështua, pasi as ju e as unë nuk kemi dështua. Mirëpo sa unë jam në dijeni se shpejti në kuvend do të shkon plotësim ndryshimi i këtij ligji dhe do të kthehet dhe do të legalizohen objektet pa e pasur certifikatën e pronës sepse në tërë territorin e Republikës së Kosovës ka probleme të shumta rreth çështjes së pronës e sigurisht se kemi edhe në këtu në komunën tonë kemi probleme kështu që unë besoj që deri në fund të vitit nuk realizohet ai planifikim atëherë vitin tjetër do ta dyfishoni apo trefishoni.

Kryesuesi – Faleminderit z.Hoxha.ateher te nderuar kolegë kuvendarë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e peste të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm të Komunës së Rahovecit për vitin financiar të përfunduar me 31.dhjetor 2020.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, raporti i auditimit të pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2020 nga zyra kombëtare e auditimit ju them me plot të drejtë se komuna e Rahovecit deri me tani nuk ka pasur ndonjëherë raport me të mirë dhe të kualifikuar si pozitiv, ku vet raporti tregon se kemi një opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare pra nuk ka theksim të çështjes. Ky raport i vitit 2020 në raport me vitin e kaluar i ka 12 rekomandime dhe këto rekomandime 50% e tyre konsideroj se janë të zbatueshme në krahasim me disa rekomandime tjera që i kemi pasur deri në këtë periudhë. Zbatimi i rekomandimeve nga ana e raportit të auditorit të vitit 2019 atëherë del se i kemi 3 rekomandime ishin zbatuar ndërsa 8 nuk ishin adresuar ende dhe 2 të tjerë ishin në proces dhe një rekomandim i mbyllur, pra janë 4 rekomandime dhe këto rekomandimet e tjera që nuk janë zbatuar atëherë konsideroj që edhe këto rekomandime janë në proces dhe deri në fund të këtij vitit edhe këto rekomandime do të mbyllën. Këto janë disa të dhëna në pika të shkurta rreth përmbajtjes së këtij raporti të auditorit, kështu që pres edhe ndonjë pyetje nga ana e juaj.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, drejtori na raportoj rreth raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2020 dhe sigurisht se unë e kam lexuar me vëmendje, kështu që nëse e marrim si opinion atëherë është mirë që ka dalë si opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare dhe kjo është mirë por do të ishte mirë edhe me tutje sikurse deri tash që i kemi pasur gjithmonë në raport të auditimit disa gjëra dhe tash janë hequr nga rendi i ditës sepse është bërë realizimi i atyre gjërave, kështu që do të ishte mirë edhe tash e tutje edhe për disa të tjera që ende figurojnë që ka dalë të largohen edhe mos me ju dhanë mundësi auditorëve edhe pse e kemi të qartë se auditorët vazhdimisht kanë mundësi në gjetjen e tyre. Por në jemi të obliguar edhe si qeverisje komunale edhe në si anëtare të kuvendit me kontribuo që mos të përsëriten gjërat nga viti në vite sigurisht nga mundësitë që kemi. Tani do të ndalem në çështjen që ka të bëjë me vonesën e pagesave të faturave p.sh. janë disa çështje që varen prej faktorit njeri dhe sigurisht se mundem me u premisue, që sipas auditorit nga 1321 raste me vlerë prej 2,661,959 euro pagesat janë realizua pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh që d.m.th. se këtë punë e dimë të gjithë si në pastaj kryetari dhe drejtorët që pagesat duhet me u krye në afatin kohor prej 30 ditësh por në vitet e tjera nuk duhet të lejohet të ndodhë diçka e tillë në të ardhmen, pastaj do të ishte mirë funksionimi i kontrollit të brendshëm me qenë me i mirë dhe me efikas si psh kemi rastin kur hyrja në obligime pa mbulesë të mjeteve pastaj vonesat në pagesa ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e obligimeve dhe shkaktojnë shtimin e shpenzimeve ,pasi që njerëzit mundohen që përmes vendimeve gjyqësore përmbaruesit apo thesarit me realizua çështjet e tyre. Unë kam shumëçka për me thënë por tani do

te rezervohem dhe do ju lë hapësire dhe kolegeve tjerë që kanë për të thënë, tani do të shkoj pak te rekomandimet pra zbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti i komunës ne bazë te auditorit te përgjithshëm nuk është i kënaqshëm pra vetëm 3 rekomandime janë zbatuar, 8 rekomandime nuk janë adresuar ende, 2 janë ne proces dhe 1 është mbyllur. Pra do të ishte mirë që rekomandimet që i bien auditori me i marr parasysh edhe me shqyrtua ne mënyrë qe sa me pak te gjetura te kemi ne raportin e auditimit.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore për komunën e Rahovecit për vitin 2020, e kam lexuar me vëmendje por që do ti cekim vetëm disa çështje që i ka cekë edhe auditori i përgjithshëm, pra te faqe 13 çështja B5 ankesa te shumta nga qytetaret për vlerësimin e pronave ne komunë për shkak te vlerësimit jo te duhur te pronave janë paraqitur 103 ankesa, ku 72 prej pronave te banimit, 25 për prona komerciale dhe 6 për prona industriale. Nga 103 ankesa vetëm 13 janë refuzuar kurse te tjerat janë pranuar si te bazuara dhe kjo tregon per nivelin e lartë te gabimeve ne bazën e te dhënave. Ndërsa ne faqe 14 çështja B6 komuna e Rahovecit ne vitin 2020 ka zhvilluar 99 aktivitete te prokurimit për punë furnizime dhe shërbime, ku prej tyre 23 aktivitete te zhvilluara nuk ishin përfshirë ne planin final te prokurimit dhe kjo tregon se ne planin e prokurimit nuk janë te përfshira te gjitha nevojat për furnizime për punë dhe per shërbime. Dhe tek faqe 15 çështja A2 zotimi i mjeteve nuk është bërë sipas rregulloreve financiare ku nga 70 mostra te testuar 38 pagesa ne vlerë prej 2,048,286 euro ku fillimisht është pranuar fatura dhe pastaj është zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja që duhet te jet e kundërta.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, para vetes e kemi raportin e auditimit te komunës tonë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për pasqyrat financiare për vitin 2020, pra, është një raport i qartë dhe gjithëpërfshirës. Kur jemi te opinioni që ka dhënë ZKA-ja, po del që opinioni është i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore dhe ne i gëzohemi këtij vlerësimi dhe ashtu siç e tha drejtori është më mirë në raport me vitin e kaluar dhe kjo është në titull por nëse shikojmë realisht në përmbajtje brenda në tekst atëherë do të shohim se ka elemente, psh nëse shikojmë titullin nuk ka modifikim nuk ka theksim të çështjes por ne përmbajtje ka theksim të çështjes ne shëndetësi keni faqe 4 ku theksimi i çështjes është se janë shpenzuar disa mijëra euro ne shëndetësi nga një kategori ne kategorinë tjetër pra nga kategoria e investimeve kapitale ne kategorinë për mallra dhe shërbime, pra kemi përsëri nje keq deklarim apo keq klasifikim sikur e kemi quajtur me përpara që ka qene edhe me përpara ne raportin e vitit paraprak, pasi megjithëse atëherë ka qenë shume i shprehur ndërsa tani është me pak por megjithatë është aty edhe auditori ne fund e thotë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak te kësaj çështje, pra ata kanë mundur edhe me modifikua por nuk kanë dashtë për shkak se këtë fenomen ja kanë bartur qeverisë ne nivel qendror për shkak se është një dukuri ku thuhet së është e përhapur ne te gjitha organizatat buxhetore dhe nuk është vetëm komuna e Rahovecit megjithëse ne kemi një lëshim që realisht nuk është dashtë te bëhet pra është ajo që ne kur e shqyrtojmë planifikimin e buxhetit kërkojmë që ajo te planifikohet saktësisht ne mënyre që te mos ketë lëvizje prej një kategorie ne kategorinë tjetër. Tek gjetjet dhe rekomandimet, ka mjaft gjetje te parregullta dhe janë te shtruar sipas çështjeve dhe në bazë te tyre pastaj vinë edhe rekomandimet që gjithsej ja 12 rekomandime dhe ne raport me vitin e kaluar që ishin 14 por prape nuk është mirë pasi do te ishte mirë që te mbeteshin vetëm 2 dhe 12 me u realizua dhe jo dy me u realizua kurse 3 apo 4 që kanë mbetur rekomandime që brenda vetes kanë mjaft te gjetura te parregullta. Tani nuk dua me i përsërit te gjitha ato që i thanë parafolësit, që është çështja B1 vonesa ne pagesat e faturave që realisht nuk është fjala për 1 apo 2 fatura por janë 1321 raste që janë paguar me vonesa, pra janë shume ato që po përsëriten dhe është diçka që ka qene edhe me përpara që keni pasur rekomandimin që këto te jenë sa me pak, ku buxheti i përgjithshëm është 2,661,950 euro që d.m.th. se gjysma e buxhetit për investime kapitale ka shkuar me pagesa me vonesa që për çka edhe keni marr vërejtje . Pastaj çështja B2 pagesa pa raporte ne detaje te pranimit për kryerjen e shërbimeve ose angazhimeve, pra nëse behet pagesa për diçka që nuk është kryer atëherë nuk është ne rregull pasi që dëmtohet buxheti dhe pastaj ka dyshime per keqpërdorime pra është pague diçka që nuk është kryer. Pastaj çështja B3 nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmeri financiare edhe kjo është diçka që nuk duhet te ndodhë sepse i kushton komunës edhe thuhet aty që nëse bën kontrata pa mbulueshmeri financiare atëherë ajo sigurisht se ka edhe shpenzimet shtesë ku përmendet aty dhe sigurisht edhe ne i kemi përmendur ne diskutime psh që organizatat e ndryshme mundem

me ju padit përmes gjyqit apo përmbaruesve dhe komuna te ketë pagesa tjera shtesë, pra i kushton buxhetit te komunës. Pra edhe unë nuk dua që tani me i përmend te gjitha këto çështje pasi besoj që janë edhe delegatet e tjerë që kanë qka me thënë por do te ndalesha pak te funksioni i auditimit te brendshëm pika 2.2.5 çështja C2 mangësitë ne funksionimin dhe zbatimin e rekomandimeve te njësisë se auditorit te brendshëm, ku thuhet këtu se ka pasur 39 rekomandime të dhëna nga auditori i brendshëm ku 26 ishin zbatuar dhe 13 ishin ne zbatim e sipër por me poshtë ajo që është shqetësuese theksohet se nga 10 raporte te përfunduara te auditimeve, vetëm zyra e prokurimit ka dërguar planin e veprimit dhe menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve dhe gjithashtu ceket se asnjë drejtori nuk e ka bërë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe sigurisht se kjo nuk është ne rregull për arsye se nëse një drejtori nuk e bën planin për zbatimin e rekomandimeve atëherë shtrohet pyetja qysh do ti zbaton ato rekomandime. Edhe tek procesi i zbatimit te rekomandimeve për vitin paraprak 2019 është cekur se nuk ka shkue zbatimi i rekomandimeve mirë ku prej te gjitha atyre 14 rekomandime që kanë qenë te dhëna vetëm 3 prej tyre janë zbatuar kurse me 8 prej tyre as që jeni marrë dhe disa prej tyre janë ne zbatim e sipër. Kështu që mendoj se zbatimi i rekomandimeve është shume me rëndësi për komunën për qeverinë komunale drejtoritë, për arsye se e kuptojmë se zbatimi i rekomandimeve kur jemi te pasqyrat financiare do te thotë një shfrytëzim sa me racional ne mënyrë që buxheti te shkojë ne vendin e duhur aty ku ndikon drejtpërdrejt ne përmirësimin e cilësisë se qytetareve.

Afrim Limani – Faleminderit shume për pyetjet dhe gjithashtu edhe për kontributin e juaj që keni dhanë, edhe unë pajtohem me ato që u thanë te gjitha mirëpo ajo që me tërhoqi vëmendjen me fol si lloj arsyetimi edhe pse kam shume për te fol mirëpo po ndërlihem tek pyetja e doktorit tek theksimi i çështjes. Ne fakt ky theksim i çështjes nuk ndikon ne bazën për opinion te auditimit mirëpo kjo ndërlihet me tepër është si kritik apo si vërejtje që ne te ardhmen ky rekomandim do te shkoj ne adrës te qeverisë, pasi këtu është fjala për afërsisht 7000 euro janë pagesa ne shëndetësi dhe te inventari, pasi ende nuk kemi te definuar një udhëzim administrativ se si me i trajtua këto si investim kapital apo ne kategorinë e investimeve. Pasi këtu e thotë qartë se çështja është ne nivel qendror dhe konsideroj që ne një formë nuk lidhet. Po ashtu edhe secili nga ju shtruat pyetjen e njëjtë rreth vonesave ne pagesa dhe kontrata pa mbulueshmëri, kështu që është e pamundur që afati ligjor për me pague një fature është 30 ditë dhe ndonjëherë nuk kemi alokim te buxhetit pastaj ndonjëherë jemi ne fund te vitit fiskal dhe e presim edhe vitin tjetër dhe krejt këto ndërlihen me atë. Po ashtu Florida tha që vërejtjet dhe ankesat te tatimi ne pronë, është një problem ku ka fillua ligji mbi tatimin ne tokë dhe vazhdimisht po na paraqiten këto probleme se softueri krijon gabime pasi supozojmë pronën tende e kanë regjistrua dikun tjetër apo e kanë dyfishua dhe natyrisht që njerëzit duhet me bo ankesa dhe përmes ankesave që është proces ligjor që ne duhet m zgjidhë. Pra krejt këto janë dhe gjithsesi ju falënderoj për kontributin e juaj që edhe ju mund te jepni ne te ardhmen një kontribut për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga ana zyrës kombëtare te auditorit.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, duke pasur parasysh edhe kohen unë po dua me ju falënderua te gjithë kolegët, kështu që kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Informatë e DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020-2021.

Avni Morina – Përshëndetje për te gjithë, unë e kam shkruar këtu përfundimi i vitit mësimor që ndoshta ka pasur ndonjë gabim pasi e dimë që përfundimi i vitit shkollor përfundon me 31 gusht.

Të nderuar anëtar komunal, drejtoria e arsimit e filloj vitin shkollor 2020-2021 sipas rekomandimeve nga Ministria e Arsimit shkencës dhe teknologjisë rreth dy javë me vonesë për shkak te rrethanave te krijuara nga pandemia Covid-19. Pas 14 shtatorit ne te gjitha shkollat e komunës tonë, mësimi u mbajt sipas skenarit A me prezencën ne shkolle duke ndërmarrë te gjitha masat mbrojtëse ndaj pandemisë siç janë paisja e objekteve mësimore me mjete higjienike dhe dezinfektues, pajisja e nxënësve me maska mbrojtëse dhe dezinfektimi i rregullt i objekteve shkollore. Ky vite mësimor vazhdoj megjithatë, megjithëse rrethanat ishin te vështira por kthimi ne objekte shkollore u dha mundësin mësimdhënësve dhe nxënësve ti kthehen normalitetit ne procesin edukativo arsimore. Për shkak te rrethanave te pandemisë pushimi vjetor ne mes gjysme vjetorit te parë dhe te dytë zgjati rreth një muaj dhe për shkak te kësaj u detyruam që gjat muajve te pranverës te zhvillojmë mësimin

edhe ditëve të shtunave ndërkohe që përfundoj gjysme vjetori i dyte i vitit mësimor mund të themi se ishte një vit mësimor i vështir për DKA-në mësimdhënësit e veçanërisht me pasoja për nxënësit por ishte pak më i lehtë se sa viti paraprak ku kishim mbyllje totale nga pandemia. Për kundër të gjitha zhvillimeve dhe vështirësive që na përcollën gjat vitit mësimor, DKA-ja u angazhua maksimalisht që gjat periudhës kur u mbajt procesi mësimor i rregullt të kemi mbarëvajtje. Në fund të gjysme vjetorit të parë nga organizatat e huaja dhe vendore monitoruese jemi shpallur komuna e parë për rezultatet e treguara për luftimin e pandemisë në shkolla përkatësisht në zbatimin korrekt dhe efikas të masave mbrojtëse të pandemisë në shkolla. Gjat vitit mësimor e sidomos në periudhën e tretë për shkak të pandemisë edhe pse i patëm të planifikuara nuk arritëm të mbajmë garat e diturisë dhe gjithashtu na munguan edhe aktivitetet kulturore dhe sportive . Të vetmen garë që u mbajtën ishin garat e olimpiadës në matematikë dhe ato të fizikanëve të rinj në nivel të shkollave në nivel komunal dhe pastaj edhe në nivel republikan. DKA edhe këto vite ka vazhduar me realizimin e projekteve të saj siç janë projektet për ndërtimin e katër objekteve shkollore nga buxheti komunal që janë në prag të finalizimit si shkolla fillore e mesme e ulët në Hoqë të Vogël „Heronjë të Kosovës„pastaj shkolla fillore e mesme e ulët „Haki Stermilli„ në Reti, shkolla fillore e mesme e ulët „Liria„ në Fortesë dhe shkolla fillore e mesme e ulët paralelja e ndarë në Kaznik, ndërsa dy shkollat e tjera që janë të financuara nga MASHT-i si „ Bajram Curri në Krushe të Madhe dhe SHFMU në Vrajakë dhe Bratotin dhe një shkolle tjetër e financuar nga MAPL që është SHFMU „Sadedin Hajda„ në Rahovec e cila se shpejti do të përurohet. Me 1 dhjetor 2020 filloj punën çerdhja e re në qytet ku është shumëfishuar numri i fëmijëve dhe kemi vazhduar me ndërtimin e tre çerdheve të reja në Krushe të Madhe në Xerxë dhe në Ratkoc të cilat shpresojmë të përurojmë gjat muajve të verës, sapo të bëhet furnizimi me inventarin e nevojshëm të cilin e kemi kërkuar me kërkesa të veçanta nga Ministria e Arsimit. Gjat këtij vitit kemi realizuar edhe dy projekte për ngrohje qendrore në dy objektet e shkollore në Pataqan të poshtëm dhe në Senoc. Gjithashtu kemi realizuar dhe po realizojmë edhe projekte të renovimit të nyjave sanitare të shkollave e ndërkohe kemi finalizuar edhe projektin e efciencës së energjisë SHFMU „Nesimi Elshani„ në Nagac dhe presim se zbatuari me projektet e efciencës edhe në tetë shkolla të tjera që kemi nënshkruar marrëveshje me fondin e Kosovës për eficientë të energjisë. Pasi u zgjat pushimi dimëror ndërmjet periudhës së parë dhe të dytë në mënyrë të pashmangshme ndodhi edhe zgjatja e përfundimit të vitit shkollor dhe ndërkohe u mbajtën të dy testet ai arritshmerisë për nxënësit e klasave të nënta dhe provimi shtetëror i maturës. Në testin e arritshmerisë kanë marr pjesë 633 semimaturant prej të cilëve 492 kanë kaluar pragun arritshmerisë që ishte 40% që shprehur në përqindje ishte 77,7%. Në provimin shtetëror të maturës i cili gjithashtu pragun e kishte 40% kanë marr pjesë 470 maturant prej të cilëve 272 kanë kaluar pragun e kalueshmërisë ose shprehur në përqindje 57,8%.Maturantet që nuk kanë arritur pragun e kalueshmërisë prej 40% do të nënshtrohen provimit shtetëror të maturës në afatin e dytë që do të mbahet në fund të muajit gusht apo në fillim të shtatorit atëherë kur MASHT të caktoj datën. Gjat muajve të verës DKA do të bëjë të gjitha përgatitjet nevojshme për një fillim sa më të mbarë të vitit shkollor 2021-2022.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sjelljen e kësaj informate rreth përfundimit të vitit mësimor të vitit 2020-2021.

Sali Sallteku - Faleminderit kryesues dhe përshëndetje për të gjithë. E kam lexuar informatën dhe e përgëzoj për informatën që ka sjell drejtori i arsimit dhe besoj që ka qenë në kuadër të kornizave që janë krye ato punë të mirëseardhura dhe të pritura. Kam një pyetje për drejtorin se a do të ketë ndonjë organizim për mësimdhënësit për vaksinimin e tyre për shkak të Covidit ku dihet se mësimi shumë shpejt duhet të fillua dhe si do të bëhet vaksinimi i mësimdhënësve.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë informatë të zgjeruar që e ka sjellë në kuvend për rrjedhat e arsimit dhe në fjalën e tij e përmendi çerdhen e qytetit që futjen në përdorim të objektit të çerdhës është shumëfishuar numri i fëmijëve. Drejtorë a i keni bërë edhe trefishimin e stafit meqenëse e dimë

që është një udhëzim administrativ i cili përcakton në mënyrë decisive se sa mund të ngarkohet një edukatore me numrin e nxënësve. Në informatën që kemi është staf i shumë i vogël pra është po ai që ka qenë në çerdhen e vjetër pra nuk është bërë ndonjë punësim i ri, a keni bërë ndonjë zgjidhje të përkohshme në këtë drejtim apo si qëndron çështja dhe pyetja tjetër është se e kemi pa e çerdhen dhe ju e keni pranuar atë objekt dhe realisht objekti është shumë i mangët dhe nuk ka klimatizim dhe nga informatat që kam temperaturat janë shumë të larta dhe nuk ka fare kushte pune aty në atë objekt. Kështu që a planifikoni për vitin e ardhshëm ndonjë zgjidhje dhe po ashtu kemi disa plato të betonit në oborrin e çerdhes dhe kemi shumë fëmijë aty mirëpo nuk ka kënde të lojërave, kështu që me intereson se a planifikoni në këtë drejtim diçka.

Avni Morina – Një numër i madhe i mësimdhënësve janë vaksinuar deri me tash dhe në nuk kemi të dhëna zyrtare se sa për qind mirëpo e di se dikun prej 745 drejtpërdrejt në mësimdhënie mbi 200 janë vaksinuar. Por është edhe një iniciativë në kuadër të asociacionit të komunave të Kosovës pra kolegji për arsim kemi ndërmarr një iniciativë që të kërkojmë nga ministria e shëndetësisë që të bëhet vaksinimi i të gjithë mësimdhënësve neper komuna, pasi që vakcina ka mjaftueshëm dhe unë shpresoj që kjo iniciativë apo ajo kërkesë e jona që është tash dhe jo vetëm kërkesë e komunës tonë por edhe e gjithë drejtorëve të drejtorive komunale të arsimit do të kalojë dhe do të organizohet vaksinimi i të gjithë mësimdhënësve para fillimit të vitit të ri shkollor. Të çerdhja është e vërtetë se është trefishuar numri i fëmijëve sepse tani objekti është shumë me i madhe se sa ka qenë përpara dhe në fillimisht kemi filluar me atë staf që kemi pasur që gjithsej i ka 9 punëtorë përfshirë edhe drejtoreshën punëtorin teknik kuzhinierja mirëpo kemi angazhuar përkohësisht edhe disa edukatore që i kemi pasur me kontrate me Kosova – me dhe sigurisht se tash sfida e kemi rritjen e stafit edhe në 3 çerdhe të reja që janë përrurimit. Kemi bërë shkresë zyrtare në ministrinë e Arsimit dhe po kërkojmë nga ministria e Arsimit që na mundësojë rritjen e stafit apo ministria e financave mirëpo përgjigje ende nuk kemi marrë dhe nëse ata nuk na lejojnë rritjen e stafit atëherë në duhet të bëjmë diçka dhe të hapim ndonjë konkurs dhe fillojmë me angazhimin e edukatoreve shtesë edhe në çerdhen e re në qytet por edhe në 3 çerdhet e tjera që planifikojmë të fillojmë me punë nga shtatori e tutje.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, vazhdojmë seancën me pikën e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje qytetar nderi z. Qemal Minxhozi.

Kryetari – I nderuar kryesues i kuvendit të Komunës së Rahovecit z. Afrim Dina, të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës të Rahovecit, të nderuar qytetar dhe ju të pranishëm. Jam i nderuar dhe krenar që sot para jush paraqes propozimin për shpalljen qytetar nderi i Rahovecit, ambasadorin i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës shkëlqesinë e tij z. Qemal Minxhozi.

Të nderuar të pranishëm, i nderuar ambasador z. Minxhozi, i nderuar Sheh Mehdi Shehu, përfaqësues i teqesë së Rifaiave në Rahovec, i nderuar Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame z. Shani Sylka, të nderuar bashkëpunëtor ju që jeni pjesë e ekipit të ambasadorit, të nderuar drejtues të organizatave të dalura nga lufta, të nderuar zonja Fahrije Hoti drejtuese e kooperativës bujqësore „Krusha“, drejtorë shkollash, bashkëpunëtor, drejtor të drejtorive.

Dikur idealistët atdhetarët këndej e andej Drinit, ëndërronin që djemtë dhe vajzat e Kosovës të emëroheshin konsuj e ambasador të republikës së Shqipërisë dhe të përfaqësonin sa me mirë interesat e Kombit tonë nëpër botë. Shumica prej neve nuk donim ta mendonim se do të vij dita kur diplomatet shqiptar do ta përfaqësojnë Shqipërinë në një vend shqiptar. Ky është fati ynë historik por nuk do të thotë që duhet të pajtohemi dhe të presim që të tjerët të na përcaktojnë fatin tonë. Të shpërndarë në gjashtë shtete të gadishullit ilirik tashme shqiptaret kanë nisur të marrin fatin e tyre në duart e tyre që të bëhen popull shtet formues. Këto copëza Shqipërie të shpërndara në sisteme politike e kanë një mundësi unike për të bërë një politikë të përbashkët ekonomike kulturore arsimore sportive rinore duke shkëmbyer përvoja dije e aftësi individuale apo grupe.

Të nderuar të pranishëm, miq e bashkëpunëtor, një shembull konkret i krejt kësaj hyrjeje është ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës shkëlqesia e tij z. Qemal

Minxhozi. Gjat viteve te tij te shërbimit diplomatik ne Republikën e Kosovës, ky burrështetas e atdhetar i përkushtuar i ra kryqe e tërthorë Kosovës, ku takoj shume njerëz të të gjitha shtresave shoqërore, bujq e blegtorë, afariste e punëtorë, nxënës e studentë, gra e burra te vyeshëm te këtij vendi, por erdhi ne Rahovec dhe aty ndaloj që te marr pak frymë, ku takoj gra që e kishin mbijetuar tragjedinë, pra gra pa burra që i kishin përveshur mëngët plagët e shpirtit dhe që punonin për të plotësuar boshllëkun që kishin lënë forcat serbe duke vrrarë e zhdukur burra e djem te rinjë. I frymëzuar nga këto gra te vyeshme dhe ambicioze dhe nga te rinjë dhe te reja që e donin jetën por që fatin dëshironin ta ndërtonin mbi forcat e veta. Ambasadori Qemal Minxhozi e kuptoj që këtyre njerëzve u duhej ndihmë dhe mbështetje konkrete prandaj nuk hezitoj që te vihet ne veprim. Angazhimi i tij prodhoh situata konkrete dhe gjendja e këtyre grave dhe te rinjve ndryshoj për mirë dhe tashmë ne fshatin Krushe e Madhe kemi një fabrikë moderne për përpunimin e perimeve ku drejtojnë dhe punojnë gratë e kësaj ane. Në këtë mënyrë ato jo vetëm që krijojnë te ardhura për familjet e tyre mirëpo i sjellin dobi te shume anshme edhe ekonomisë se Republikës se Kosovës. Eksporti i prodhimeve bujqësore te Krushes se Madhe përbën një nder tregimet me te suksesshme te kohëve te fundit. Ndihma konkrete që ambasadori Minxhozi do te shënohet me shkronja te arta ne historinë e komunës se Rahovecit ndërsa emri i tij do te mbahet mend gjatë. Ai u kujdes që edhe prodhimtaria e rrushit dhe verës t njihet sa me gjërë jo vetëm ne trojet shqiptare por edhe me tutje. Promovimi medial që ambasadori Minxhozi i ka bërë komunës se Rahovecit është unik dhe kjo ka bërë që komuna e Rahovecit ndonëse e vogël ne shtrirje gjeografike te identifikohet si rajon vreshtar dhe rajon per prodhimin dhe përpunimin e perimeve cilësore. Diplomacia ekonomike është trend botëror ndërsa integrimi ekonomik ndërmjet rajoneve shqiptare është hap i parë dhe shume i rëndësishëm për shqiptarët ne rajon. Ky integrim do te ndikoj ne një reaksion zingjir duk i lidhur shqiptarët fuqishëm ne interesa ekonomike kulturore sportive edukative arsimore tregtare dhe fusha te tjera te interesit te përbashkët. Në këtë menyrë ambasadori Minxhozi e ka kryer me përkushtim detyrën e tij duke u fokusuar ne nxitjen e bashkëpunimit ekonomik e kulturore ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Republikës se Kosovës. Janë këto disa nga arsytet që me shtynë që kuvendit te komunës se Rahovecit ti propozoj që ambasadorit te jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës se Shqipërisë shkëlqesia e tij z. Qemal Minxhozi te shpallet qytetar nderi i komunës se Rahovecit, propozim që ju kuvendarë te nderuar shpresoj që ta miratoni me zemërgjerësi e dashamirësi. Jam i nderuar dhe i privilegjuar që ne emrin tim, ne emrin e kuvendareve, qytetareve te komunës se Rahovecit pas pak te ja uroj këtë titull nderi ambasadorit te Republikës se Shqipërisë ne Republikën e Kosovës z. Qemal Minxhozi duke i thënë ju vërtet jeni nderi i komunës tonë por jeni edhe nderi i shqiptarisë. Ta mbani me nder e krenari dhe te vazhdoni te jeni ne shërbim t kauzës tonë te përbashkët. Zoti ambasador Qemal Minxhozi faleminderit për gjithçka që keni bërë per Republikën e Kosovës e për shqiptarët e posaçërisht për gjithçka që keni bërë për qytetaret e komunës se Rahovecit. Ju faleminderit për vëmendjen e juaj!

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar, tani për jetën dhe veprën te ambasadorit tonë te respektuar z. Qemal Minxhozi do te flas z. Qemal Krasniqi.

Qemal Krasniqi – I nderuar kryetari i Komunës, i nderuar kryesues i Kuvendit z. Dina, anëtar te kuvendit, qytetar te nderuar. Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush te paraqes një hyrje e një jetëshkrim te ambasadorit te jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës se Shqipërisë ne Republikën e Kosovës z. Qemal Minxhozi. Qemal Tahir Minxhozi i lindur ne Prill te vitit 1953 ne Burrel te Republikës se Shqipërisë. Në vitet 1968-1972 i kreu studimet ne shkollën e mesme te gjuhëve te huaja ne Tiranë ndërsa ne periudhën 1972-1975 i përfundoj studimet ne universitetin e Tiranës për gjuhë angleze. Ka punuar mësues dhe ka kryer punë te ndryshme ne ngritjen e projekteve madhore ne interes te atdheut. Me ndryshimin e sistemit, Qemal Minxhozi u angazhua ne projekte te ndryshme me institucionet e Danimarkës duke realizuar projekte te ndryshme ne fushën e arsimit shkencës kulturës mediave sistemit gjuhësor etj. Ndihamoj ne hapjen e disa institucioneve te rëndësishme te Shqipërisë me financim danez siç janë fondacioni i zgjidhjes se konflikteve, fondacioni i hapur shqiptar, avokati i popullit, instituti i mediave që te gjitha këto për një periudhë dhjetë vjeçare. Falë kësaj punë u emërua shef i misionit te parë shef i misionit te parë i Republikës se Shqipërisë ne Danimarkë ne periudhën 2002-2005. Në dy mandate 2005-2013 u zgjodh deputet ne Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

ndërsa ne mars te vitit 2014 u emërua ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë i Republikës se Shqipërisë ne Republikën e Kosovës, detyrë që vazhdon me krye ende. Dhe dikush natyrshëm mund te pyes se çfarë ka bërë ky njeri per qytetaret e Kosovës dhe te Komunës se Rahovecit dhe ne do ti japim disa arsyetime. Që prej 13 marsit vitit 2014 z. Minxhozi mban postin e Republikës se Shqipërisë ne Republikën e Kosovës, që nga kjo kohë ambasadorin e nderuar Minxhozi ka shkuar gjithandej neper Kosovë dhe marr pjesë ne gëzimet e hidhërimet tona, ku ka hyre familjet tona dhe ka përjetuar dhembjen që kemi ndjerë për njerëzit tanë te vrarë e te humbur ne luftën tonë për çlirimin nga kriminelet serb. Dhimbjen tonë ai është munduar që ta kthejë ne forcë dhe ne këtë mënyrë ka ndihmuar ne shërimin e plagëve tona që edhe sot kullojnë gjak. Ambasadori Minxhozi ka parë nga afër luftën e fortë te grave që nënat dhe motrat tona kanë bërë për mbijetesë, dhe nuk ka ndenjur duarkryq që duke parë se si këto gra bëjnë gjithçka për ardhmërinë e fëmijëve te tyre por i ka përveshur mëngët dhe ju ka ofruar mbështetje konkrete morale e materiale. Ambasadori Minxhozi mundësoj që bujqit tanë te kenë sigurim bankat dhe të marrin kredi me te favorshme që do te ju jepte mundësi për një prodhim te ri me te lartë bujqësore. Ambasadori Qemal Minxhozi ka ndërmjetësuar ne KEDS që te instaloj një transformator te energjisë elektrike per fabrikën për përpunimin e perimeve ne Krushe te Madhe te drejtuara nga gratë e veja te këtij fshati. Ambasadori Minxhozi ka ndërmjetësuar për rregullimin e infrastrukturës për këtë fabrikë për pajisjen me inventar te brendshëm te nevojshme për gratë që punojnë ne këtë fabrikë. Ambasadori Minxhozi ka ndihmuar ne rregullimet e nevojshme ne hapësirat rreth e rrotull te kësaj fabrike duke e bërë atë sa me funksionale. Ambasadori Minxhozi ka ndikuar që 70 gra te bëjnë kontrolla e analiza mjekësore dhe vizita te oftamologu dhe ato që kishin nevojë per syze te i marrin ato falas. Ambasadori Minxhozi ka ndihmuar ne promovimin e vlerave kulturore promovimin e turizmit rural dhe te burimeve tona natyrore. Ambasadori Minxhozi ka qenë i kujdesshëm edhe me rininë e Rahovecit duke i vizituar ata ne qendrën e këtushme rimore duke ju dhënë këshilla te vyeshme që mund te ju hynë në punë te rinjve për ta ndërtuar te ardhmen e tyre. Pra me nje fjalë ambasadori dhe shkëlqesia e tij Qemal Minxhozi ka frymuar me Rahovecin gjat kohës sa është ne shërbim diplomatik te Republikës se Shqipërisë ne Kosovë. Për këto arsye mendoj se kuvendi i Komunës se Rahovecit do ta votoj propozimin e kryetarit për shpallje qytetar nderi i Komunës se Rahovecit për ambasadorin Qemal Minxhozi. Duke bërë këtë akt moral se bashku e kryejmë një obligim moral që kemi ndaj ambasadorit Minxhozi dhe ne këtë mënyrë ti dërgojmë një mesazh falënderimi mirënjohje e respekti që kemi për te dhe për kontributin që ka dhënë për afirmimin e komunës se Rahovecit ne shume fusha. Ju falënderojmë për vëmendjen tuaj!

Kryesuesi – I nderuar kryetar i komunës z. Latifi, te nderuar anëtarë te kuvendit komunal, të nderuar përfaqësues te klerit fetar, media, i nderuar ambasador z. Minxhozi dhe mirë se erdhe ne Rahovec. Kënaqësi dhe nder që ne këtë mbledhje që kjo legjislature te shpallë qytetar nderi shkëlqesinë e tij ambasadorin z. Qemal Minxhozi. Shqipëria nder vite e shekuj ka bërë shume për ne ne çdo kohë, ishin vitet 1999 kur Republika e Shqipërisë u organizua me gjithë arsenalin ushtarak dhe forcën e tyre për te ju dalë ne ndihmë vëllezërve te tyre ne Kosovë. Koha kur vëllezërit tanë hapen dyert për të na strehuar dhe kujdesur për ne. Faleminderit Shqipëri!

Puna dhe angazhimi i ambasadorit z. Minxhozi është i jashtëzakonshëm për qytetaret e Republikës se Kosovës dhe ne veçanti për qytetaret e Komunës sonë duke ndihmuar ne zhvillimin e ekonomisë promovimin e vlerave kulturore turizmit dhe burimeve tona natyrore. I nderuar ambasador ne emrin tim dhe te anëtareve te kuvendit komunal te Rahovecit dhe gjithë qytetareve tonë ju falënderojmë për punën dhe kontributin tuaj. Faleminderit i nderuar!

Të nderuar anëtar te kuvendit, tani fjalën ja jap Rasim Fazliut shef i grupit parlamentar të Partisë Demokratike te Kosovës.

Rasim Fazliu – Faleminderit i nderuari kryesues, përshëndetje kryetar Latifi, përfaqësues te bashkësive fetare, përshëndetje për te gjithë te pranishmit. Më lejoni që ne emër te grupit parlamentar te PDK-së te këtij kuvendi ta përshëndes ambasadorin e Republikës se Shqipërisë ne Kosovë, shkëlqesinë e tij z. Qemal Minxhozi dhe e falënderojmë shume për pjesëmarrje. Gjithashtu ne emër te grupit te PDK-së e mbështesim me kënaqësi propozimin e kryetarit dhe e falënderojmë kryetarin për këtë iniciativë se vërtet kemi edhe nderin e veçante që

ambasadorin Minxhozi te shpallim qytetar nderi te Komunes se Rahovecit. Kështu që kryetar e keni mbështetjen e grupit parlamentar te PDK-së. Faleminderit!

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar Latifi, i nderuar ambasador Minxhozi, te nderuar përfaqësues te klerit fetar, te nderuar përfaqësues nga ambasada e Republikës se Shqipërisë ne Kosovë, të dashur mysafirë. Është kënaqësi për ne, si anëtarë te Kuvendit te Rahovecit që kemi mundësi që ta votojmë dhe te përkrahim një vendim për shpallje qytetar nderi te ambasadorit z. Minxhozi. Ne emër te grupit te Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ne Kuvendin komunal te Rahovecit i japim mbështetje te plotë këtij vendimi. Urime shkëlqesia juaj, ambasador z. Qemal Minxhozi.

Fehmi Cena – Përhëndetje për te gjithë te pranishmit. Në emrin tim dhe ne emër te grupit te delegateve te Lidhjes Demokratike te Kosovës ne kuvendin komunal te Rahovecit një përhëndetje te veçantë për ambasadorin fuqiptotë te Republikës se Shqipërisë ne Republikën e Kosovës z. Qemal Minxhozi. Duke u bazuar ne atë që u tha ne kontributin e ambasadorit per komunën tonë ne fushën e kulturës, biznesit, ne si grup parlamentar i LDK-së jemi plotësisht dakord me iniciativën e kryetarit te komunës se Rahovecit z. Latifi, që ambasadori aktual i Republikës se Shqipërisë z. Minxhozi te shpallet qytetar nderi i komunës tonë, që do te jetë nder për ne. Urime ambasador z. Minxhozi.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, çfarë mund te them un sot kur kemi përpara ambasadorin fuqiptotë te Republikës se Shqipërisë te një Shqipërie londineze apo te një Shqipërie përtej Drinit siç thoshte i ndjeri Dritëro Agolli dhe kur brezat e tërë kanë punuar dhe madje kanë flijuar jetën për te qenë sot ky ambasador këtu dhe te jemi gjithë e me tepër se për kaq. Por megjithatë ne jemi te lumtur që është propozuar per qytetar nderi i Komunes se Rahovecit, prandaj z. Ambasador e keni përkrahjen dhe jemi shume te lumtur që kemi nderin që ta kemi një qytetar dhe madje ambasador ne komunën tonë me atë kontribut që ka dhënë dhe kontributet që do te jep edhe ne te ardhmen. Urime i nderuar z. Ambasador Qemal Minxhozi!

Te nderuar anëtarë te Kuvendit, tani e qesim ne votim propozimin e kryetarit për shpalljen qytetar nderi te ambasadorit z. Qemal Minxhozi.

Atëherë konstatoj se unanimisht shpallet qytetar nderi i Komunes tonë, z. Qemal Minxhozi. URIME

Tani ftojë kryetarin e Komunes z. Smajl Latifi që te ndajë titullin qytetar nderi për ambasadorin z. Qemal Minxhozi.

Te nderuar te pranishëm, me kënaqësinë me te madhe ftojë për një fjalë rasti ambasadorin z. Minxhozi.

Qemal Minxhozi – I nderuar kryesues, i nderuar kryetar i Komunes, i nderuar Sheh Myhediu, te nderuar anëtarë te asamblesë te Komunes se Rahovecit. Jam shume i privilegjuar për këtë nder te jashtëzakonshëm që më bëni në një ditë te jashtëzakonshme. Kur jam caktuar ambasador ne Kosovë, pyetjen e parë që i bëra vetes ishte se sa do te jem ne gjendje për te ju shpjeguar një besim te madhe dhe e fillova me disa vizita ne komunat e Kosovës për te parë se çfar mund te ofroj për diçka te veçante këtu. Fjala ambasador ne një vend te huaj është diçka shume e madhe sepse je përfaqësuesi i shtetit i popullit te atij vendi ku shkon. Ndërsa ambasador i Shqipërisë ne Kosovë për mendimin tim nuk do te duhej te ishte e nevojshme për te qenë fare. Por historia kështu e solli që edhe unë te jem një ambasador si gjithë te tjerët dhe jam munduar që nga dita e parë që te përçoj disa mesazhe jo thjesht vëllazërimi sepse ne jemi vëllezër ne jemi një gjak ne jemi një komb. Po çfar mund te bëj për këta njerëz që te bashkohemi edhe me tepër, që shume nga fjalët e mia i mori kryetari i Komunes Latifi te cilin e përgëzoj shume nga zemra për nismën dhe me këtë rast u jam shume mirënjohës juve dhe gjitha atyre njerëzve që kanë kontribuar. Kështu që gjëja me e madhe që mund te bëjmë është ti japim një zhvillim te ndërsjellët që te mos jemi thjesht dy shtete por me tepër se dy shtete te jemi një komb dhe kombi zhvillohet me një energji te jashtëzakonshme te dy kahjeve te kufirit. Arsyeja se pse Rahoveci është i veçante për mua sepse është një nga rajonet me te goditura nga okuptari serb por jo vetëm gjate vitit 99 por ne vazhdimësi gjate gjithë historisë se saj me padrejtësi gjenocid sulme makabre deri te zhdukja e njerëzve me vrasje te familjareve nga regjimi serbë Është një nga zonat me te goditura te Kosovës dhe kjo është e para që me lidh mua me shume me Rahovecin. Pastaj e dyta është se këtu kam parë një popullsi njerëz që nuk jetuan thjesht me te shkuarën por me te ardhmen se çfar duhet te bëjmë jo që te mbijetojmë por te jetojmë dinjitetshëm në një vend të zhuritur nga lufta dhe popullsia e Rahovecit me ne krye Krushen e Madhe arriti që

të ja dalë mbanë. Dhe e treta, Rahovecin që kurrkush nuk e mendonte 10 apo 15 vite përpara që do te kthehet ne një kantiere te madhe te prodhimit e sidomos ne fushën e bujqësisë dhe prodhimit te rrushit te përpunimit te verës dhe rakisë që është bërë një shembull jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin. Jam munduar ë produktet e Kosovës dhe te Rahovecit te promovoj sa te jetë e mundur ne Shqipëri dhe kemi disa arritje që themi diçka që me veraritë e Rahovecit ka një rritje nga viti 2016 deri me sot 300% eksporte me tepër se ne te kaluarën.

Te dashur vëllezër dhe motra, patriotizmin patjetër që do ta kthejmë ne ekonomi, ne zhvillim dhe patjetër që do ta kthejmë për tu bërë elitë ne prodhim dhe zhvillim dhe unë shikoj Rahovecin që pas 5-6 vite të ardhshme një toskanë te Italisë por ne Kosovë pasi kemi shume me tepër aspirata dhe gjersa që Rahoveci duhet te ecën me përpara që te ndalen emigrimet dhe Italin Gjermanin Zvicren e Francen ta ndërtojmë këtu sepse kete e ka bërë zoti një vend te bekuar dhe njerzit që nuk u perkulen as ndaj okupuesit serb por triumfuan dhe ja kanë arritur sot që te jet një komunë me nje zhvillim shume pozitiv. Unë them që te jesh qytetar nderi i Rahovecit është shume me tepër se një titull. Ky nderim dhe ky respekt që me behet mua sot do te jetë një gurë themel shume i rëndësishëm për familjen time per te treguar lidhjet që kemi me Kosovën dhe unë jam shpresë plotë që se bashku ne kemi shume punë për te bërë përpara. Dhe unë falënderoj gjithsecilin prej jush këtu ne sallë dhe jashtë kësaj salle dhe nuk do te jem thjesht nje ambasador nje politikan por do te jem një person që jam nga Rahoveci sepse me keni nderuar shume.

Kryesuesi – Faleminderit shume z.ambasador Minxhozi,te nderuar anëtare te kuvendit duke ju falënderuar te gjithëve për kontributin e dhënë dhe mirë u pafshim ne mbledhjet e radhës.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

-III- Nr. I prot. 3878 Më 11.08 20 21
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	11.08.2021
Referenc-ë	
Për/Za/To:	z.Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit
CC:	Anëtarët e kuvendit komunal të Rahovecit
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë



Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka planin 5 vjeçar të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike 2016-2021 i miratuar në dhjetor të vitit 2016 nga ekspert të fushave të drejtorisë së shërbimeve publike si dhe me ndihmën e mbështetur nga ekspert të projektit DEMOS.

Komuna ka sipërfaqe prej 275,5 km², me 35 vendbanime dhe një qendër urbane.

Zonat e përfshirjes së HHP-ve në këtë dokument përfshin;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit, të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim automjetesh
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore, etj..

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe gjelbërime, 6944 m²
- Sheshe, 865m²
- Shëtitore pranë lumit, 3100 m²
- HHP-të pranë lapidareve, 44 m²
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore, 4552 m²
- Varreza të dëshmoreve, 7528 m²

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

- Varreza të martireve, 4750m²
- Varreza në zonën urbane, 99921.5 m²
- Varreza në zonën rurale, 147997 m²

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat, duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lyerja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Ne si komunë e Rahovecit kemi kontraktuar tre operator ekonomik që kujdesen për mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ky projekt i ndarë në 3 Lote;

- Lot 1- 65,600.77 euro,
- Lot 2- 22,770.34 euro,
- Lot 3- 19,990.50 euro, ky projekt është në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe specifike e këtij viti është se hapësirat publike llogariten edhe shtigjet e ecjes dhe investimet tjera në kuadër të kësaj drejtorie.

Vlera e tyre në total për tre operator ekonomik sillet në 108,361.61 euro.

Po ashtu sivjet pritet të mbyllet ky plan që ka një afat prej 5 viteve, duke e ditur se nga viti i ardhshëm ne do të mundohemi të bëjmë planifikimet për të risjellur dhe rishikuar në detaje planin e ri investim në hapësira publike.

Për me shumë detaje dhe sqarime tjera, do të jemi të hapur të diskutojmë gjatë mbledhjes së KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtoria e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, nenit 10, 40, 57 parragrafit 1.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2021 merr këtë:

V E N D I M

Për ri-destinim të mjeteve buxhetore për vitin 2021

1. **MIRATOHET** Vendimi për ri-destinimin e mjeteve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2021 në shumën e prej **192,719.51** , në këto kategori të cekura më poshtë:
 2. Nga programi Kultura, Rinia dhe Sportet (850), nën programi Shërbimet Kulturore (85011), kodi funksional (0820), fondi burimor (21), nga projekti: **Restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruar në Krushë të Madhe** kodi i projektit 48201, shuma prej **5,000.00 €**.
 - 2.1. Të transferohen në programin Kultura, Rinia dhe Sportet (850), nën programi Shërbimet Kulturore (85011), kodi funksional (0820), në fondin burimor (21), në projektin: **Projekte me bashkëfinancim (në kulturë, rini dhe sport)** kodi i projektit (40862), shuma prej **5,000.00 €**.
 - 2.2 Nga programi Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndërtimi i QMF-së në Oploterushë** kodi i projektit (49836), shuma prej **21,170.00 €**.
 - 2.2.1 Të transferohen në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i AMF-së në lagjen e Epërme** kodi i projektit (50771), shuma prej **21,170.00 €**.
 - 2.3 Nga programi Zhvillimi Ekonomik (470), nën programi Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (47011), kodi funksional (0411), fondi burimor (10), nga projekti: **Tregu i gjelbër ditor** kodi i projektit (48058), shuma prej **10,000.00 €**,
 - 2.3.1 Të transferohen në programin Zhvillimi Ekonomik (470), nën programi Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (47011), kodi funksional (0411), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i shtëpisë së pleqve**, kodi i projektit (48051) shuma prej **10,000.00 €**.

2.4 Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga **Shpenzimet komunale** (14), shuma prej **20,000.00 €**,

2.4.1 Të transferohen në programin Zyra e kryetarit (160), nën programi Zyra e kryetarit (16011), kodi funksional (0111), në fondin burimor (21), në **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.5 Nga programi Bujqësia, pylltaria dhe zhvillim (470), nën programi Bujqësia (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (21), nga **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.5.1 Të transferohen në programin Zyra e kryetarit (160), nën programi Zyra e kryetarit (16011), kodi funksional (0111), në fondin burimor (21), në **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.6 Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (21), nga projekti: **Ndërtimi i busteve te Deshmoreve** kodi i projektit (43494), shuma prej **10,000.00 €**,

2.6.1 Të transferohen në programin Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), në fondin burimor (10), në projektin: **Hartimi i projekteve te ndryshme** kodi i projektit (40839), shuma prej **10,000.00 €**,

2.7 Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kodi funksional (0411), fondi burimor (21), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në zonën ekonomike ne Opterushë** kodi i projektit (45690), shuma prej **15,000.00 €**,

2.7.1 Të transferohen në programin Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacion të autobusëve në Rahovec** kodi i projektit (49887), shuma prej **15,000.00 €**,

2.8 Nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (10, 21), nga projekti: **Stalla dhe ferma të vogla për fermerë** kodi i projektit (47865), shuma prej **30,000.00 €**,

2.8.1 Të transferohen në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), në fondin burimor (10, 21), në projektin: **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore** kodi i projektit (40822), shuma prej **30,000.00 €**,

2.9 Nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (21), nga projekti: **Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit** kodi i projektit (43482), shuma prej **15,000.00 €**,

2.9.1 Të transferohen në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), në fondin burimor (21), në projektin: **Ndërtimi i serave me participim 75 me 25 %** kodi i projektit (46674), shuma prej **15,000.00 €**,

2.10 Nga programi Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndërtimi I rrugës Rahovec-Pataqan I Poshtëm** kodi i projektit (43468), shuma prej **35,000.00 €**,

2.10.1 Të transferohen në programin Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovec** kodi i projektit (40817), shuma prej **35,000.00 €**.

2.11 Nga programi Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti: **Krijimi i parkingjeve të reja në qytet** kodi i projektit (48045), shuma prej **11,549.51 €**,

2.11.1 Të transferohen në programin Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit** kodi i projektit (40817), shuma prej **11,549.51 €**,

3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit do të jetë Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës ,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr- ___/21
Me datë: 31.08.2021

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 nenit 14.1 dhe nenit 17 dh nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.27/2008, nenit 74 parragrafit 2 pika 2.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i ::

PROPOZON

Për ri-destinim të mjeteve buxhetore për vitin 2021

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i Propozon që të miratohet propozimi për ri-destinimi i mjeteve buxhetore për vitin 2021 në shumën e prej **192,719.51** në këto kategori të cekura si më poshtë:

2. Nga programi Kultura, Rinia dhe Sportet (850), nën programi Shërbimet Kulturore (85011), kodi funksional (0820), fondi burimor (21), nga projekti: **Restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruar në Krushë të Madhe** kodi i projektit 48201, shuma prej **5,000.00 €**.


2.1. Të transferohen në programin Kultura, Rinia dhe Sportet (850), nën programi Shërbimet Kulturore (85011), kodi funksional (0820), në fondin burimor (21), në projektin: **Projekte me bashkfinancim (në kulturë, rini dhe sport)** kodi i projektit (40862), shuma prej **5,000.00 €**.

2.2 Nga programi Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndërtimi i QMF-së në Apterushë** kodi i projektit (49836), shuma prej **21,170.00 €**.

2.2.1 Të transferohen në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i AMF-së në lagjën e Epërme** kodi i projektit (50771), shuma prej **21,170.00 €**.

2.3 Nga programi Zhvillimi Ekonomik (470), nën programi Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (47011), kodi funksional (0411), fondi burimor (10), nga projekti: **Tregu i gjelbërt ditë** kodi i projektit (48058), shuma prej **10,000.00 €**.

2.3.1 Të transferohen në programin Zhvillimi Ekonomik (470), nën programi Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (47011), kodi funksional (0411), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i shtëpisë së pleqve**, kodi i projektit (48051) shuma prej **10,000.00 €**.



2.4 Nga programi Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga **Shpenzimet komunale** (14), shuma prej **20,000.00 €**,

2.4.1 Të transferohen në programin Zyra e kryetarit (160), nën programi Zyra e kryetarit (16011), kodi funksional (0111), në fondin burimor (21), në **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.5 Nga programi Bujqësia, pylltaria dhe zhvillim (470), nën programi Bujqësia (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (21), nga **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.5.1 Të transferohen në programin Zyra e kryetarit (160), nën programi Zyra e kryetarit (16011), kodi funksional (0111), në fondin burimor (21), në **Subvencione dhe transfere** (20), shuma prej **20,000.00 €**,

2.6 Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (21), nga projekti: **Ndertimi i busteve te Deshmoreve** kodi i projektit (43494), shuma prej **10,000.00 €**,

2.6.1 Të transferohen në programin Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), në fondin burimor (10), në projektin: **Hartimi i projekteve te ndryshme** kodi i projektit (40839), shuma prej **10,000.00 €**,

2.7 Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kodi funksional (0411), fondi burimor (21), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime në zonën ekonomike ne Apterushë** kodi i projektit (45690), shuma prej **15,000.00 €**,

2.7.1 Të transferohen në programin Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacion të autobusëve në Rahovec** kodi i projektit (49887), shuma prej **15,000.00 €**,

2.8 Nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (10, 21), nga projekti: **Stalla dhe ferma të vogla për fermerë** kodi i projektit (47865), shuma prej **30,000.00 €**,

2.8.1 Të transferohen në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), në fondin burimor (10, 21), në projektin: **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore** kodi i projektit (40822), shuma prej **30,000.00 €**,

2.9 Nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), fondi burimor (21), nga projekti: **Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit** kodi i projektit (43482), shuma prej **15,000.00 €**,

2.9.1 Të transferohen në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), në fondin burimor (21), në projektin: **Ndërtimi i serave me participim 75 me 25 %** kodi i projektit (46674), shuma prej **15,000.00 €**,

2.10 Nga programi Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti: **Ndërtimi I rrugës Rahovec-Pataqan I Poshtem** kodi i projektit (43468), shuma prej **35,000.00 €**,

2.10.1 Të transferohen në programin Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i rrugeve ne komunën e Rahovec** kodi i projektit (40817), shuma prej **35,000.00 €**.

2.11 Nga programi Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga projekti: **Krijimi i parkingjeve të reja në qytet** kodi i projektit (48045), shuma prej **11,549.51 €**,

2.11.1 Të transferohen në programin Shërbime publie, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi i rrugeve në komunën e Rahovecit** kodi i projektit (40817), shuma prej **11,549.51 €**,

3. Qëllimi i këtij Propozimi për re-destinimin e mjeteve buxhetore për vitin 2021 është efikasiteti i menaxhimit me mjetet buxhetore, vazhdimi i investimit në projektet prioritare për Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky Propozim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:

- **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,**
- **Sekretaria e Kuvendit, dhe**
- **Arkivi.**

Smaj Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) lidhur me nenin 40, paragrafi 2, pika (a) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008” e në mbështetje të nenit 22, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, konform nenit 27, pika 5, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të dispozitave të neneve 10, 57 paragrafi 1.3, lidhur me nenin 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr-1005, i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë, 31.08.2021 miraton këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.276/2009, të datës 02.07.2010

Neni 1

MIRATOHET vendimi për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 40 (dyzet) viteve të pronës së paluajtshme të Komunës, në fshatin Bellacërkë të Komunës së Rahovecit, për shkak të mos përmbushjes së vendimit të Kuvendit të Komunës dhe kontratës në tërësi nga përfituesit, duke u bazuar në raportin e komisionit për konstatimin e gjendjes faktike dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës për shfrytëzimin e parcelës si më poshtë:

- 1.1 Parcela Nr.381 në vendin e quajtur “Kodra” në sipërfaqe prej 11.37.36 ha, nga certifikata Nr. 117 zk Bellacërkë, Psh e Kosovës, me titullar KK Rahovec.

Neni 2

OBLIGOHET; Kryetari i Komunës që pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, të nxjerr vendim për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 40 (dyzet) viteve, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve të dala nga vendimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01-Nr.276/2009, të datës 02.07.2010, të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Bellacërkë.

Neni 3.

Të Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ta largoj nga lista e shfrytëzuesit përfituesin e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit dhe parcela të kthehet në gjendjen e mëparshme titullarit përkatësisht Komunës së Rahovecit.

Neni 4.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. ___/21
Me datë:31.08.2021

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Kuvendi komunal Rahovec, duke vendosur sipas kërkesës së ndërmarrjes private "LI KOS Toprak me seli në Prizren, 08 nr. 2774 të dt. 12.10.2009 për shpalljen e interesit të përgjithshëm shoqëror për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheu – blloka, tulla dhe tjegulla në Bellacërkë, në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-139, nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, nenit 40.2 – të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08 dhe nenit 11. dhe 13. të Ligjit mbi procedurën administrative nr. 02/L28, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 8/2007, merr

V E N D I M

Mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm shoqëror për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut – blloka, tulla dhe tjegulla në fshatin Bellacërkë

Neni 1.

Me këtë Vendim, vërtetohet se është nga interesi i përgjithshëm shoqëror ndërtimi i Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut – blloka, tulla dhe tjegulla në fshatin Bellacërkë. Objekti do të ndërtohet sipas projektit të cilin e ka siguruar firma në fjalë.

Neni 2.

Ngritja e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut – blloka, tulla dhe tjegulla do të ndërtohet në parcelën kadastrale nr. 381/2 sipas kulturës kullosë (djerrinë) në sipërfaqe prej 11.37,36 ha, nga çertifikata nr. 81 nr. Z.k. Bellacërkë në emër të PSH të Kosovës, titullar KK Rahovec.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm, shërbime komunale, kadastrë, gjeodezi, pronë dhe mjedisi – Sektori për kadastrë, gjeodezi dhe pronë e KK Rahovecit.

Neni 4.

Vendimi hynë në fuqi me ditën e miratimit nga Kuvendi komunal Rahovec.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 276/2010

Rahovec, 2-07-2010

Kryesuesi:
Kujtim Popaj





Kuvendit komunal Rahovec, duke shqyrtuar sipas kërkesës së Kompanisë Li – Kos Toprak, nga Turqia, me seli në Prizren, 08 nr. 2774 të dt. 12.10.2009, në çështjen administrative – ndarjen e tokës shtetërore në shfrytëzim, për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut (blloka, tulla dhe tjegulla) në z.k. Bellacërkë, në bazë të nenit 52. të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 8. të Ligjit për partneritetet publiko – private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënjedn e tyre nr. 03/L-090 nenit 5. dhe 36 Statutit të komunës së Rahovecit, nenit 14, 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokat ndërtimore, “Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 14/80 dhe nenit 13. të Ligjit mbi procedurën administrative, nr. 02/L-28, merr

A K T V E N D I M

I.- APROVOHET kërkesa e Kompanisë Li – Kos Toprak, nga Turqia, me seli në Prizren, dhe i **NDAHET** në shfrytëzim, në afat prej 40 (dyzet) vjet, nga data e hyrjes së marrëveshjes, për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut (blloka, tulla dhe tjegulla), parcela nr. 381/2, në vend të quajtur “Kodra”, sipas kulturës kullosë (djerrinë), në sipërfaqe prej 11.37,36 ha, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 117. z.k. Bellacërkë, PSH e Kosovës, titullar KK Rahovec.

II.- Të drejtat për shfrytëzimin dhe eksploatimin e infrastrukturës publike, përjashtimisht nga paragrafi 1. të nenit 8. dhe në pajtim me paragrafin 3. të nenit 60 të Ligjit material, mund të vazhdohet kohozgjatja e marrëveshjes (kontratës) e cila nuk mund të jetë më shumë se $\frac{1}{4}$ (një e katërta) e kohëzgjatjes fillestare e cila do të caktohet në marrëveshje ose kontratë.

III.- Të drejtat dhe obligimet për dhënjën e tokës shtetërore në shfrytëzim, në kohë të caktuar, do të rregullohet me marrëveshje ose kontratë të veçant në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi mbi tokat ndërtimore, ndërmjet KK Rahovecit në një anë dhe shfrytëzuesit, Kompanisë Li – Kos Toprak, nga Turqia, me seli në Prizren, rruga “Jeronim de Rada” nr. 2. në anën tjetër.

IV.- Nëse shfrytëzuesi i tokës shtetërore, në afat prej 3 (tre) vjetëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi nuk ndërton objektin, ose nuk i kryen punët të konsiderueshme në ndërtimin e objektit industrial, komuna e Rahovecit, do të merr vendim mbi iniciimin e procedurës për denoncimin e kontratës për dhënjën e tokës shtetërore në shfrytëzim, nën kushtet dhe mënyrën e caktuar sipas dispozitave të ligjit mbi tokën ndërtimore dhe Vendimit të KK Rahovecit.

A r s y e t i m

Kompania private “Li – Kos Toprak”, nga Turqia, me seli në Prizren, me kërkesën e vetë 08 nr. 2774 të dt. 12. 10. 2009, është drejtuar këtij Kuvendi, që për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut, në Bellacërkë, t,iu ndahet në shfrytëzim, parcela shtetërore më afër e cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke theksuar përveç tjerash se është e gatshme t,i ofrojë komunës të gjitha garancionet të kërkuara, ndërsa kohë më parë lidhur me këtë çështje administrative ka zhvilluar bisedimet me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Odën ekonomike në Prishtinë, dhe udhëheqësit komunal, të cilët kanë përkrahur iniciativën, që në komunën e Rahovecit, të ndërtohet një Fabrikë për përpunimin e prodhimeve prej dheut, pasi që këto prodhime kryesisht improtohen nga Serbia dhe Maqedonia. Sipas analizave të kryera, nga ana e

ekspertëve të tyre, lokacioni në Bellacërkë, për nga kualiteti i dheut është treguar më i përshtatshëm dhe posedon lëndën e parë të mjaftueshme për zhvillimin e prodhimit të prodhimit në fjalë. Kompania ka siguruar edhe Projektin ideor i cili është bashkangjitur kërkesës.

Kërkesa me të gjitha shkresat e lëndës është ceduar Drejtorisë për urbanizëm, shërbime komunale, kadastër, gjeodezi, pronë dhe mjedisi – Sektori për kadastër, gjeodezi dhe pronë, që të njëjtën të përgatitë dhe të dërgojë në shqyrtim dhe vendosje Kuvend.

Kjo drejtori nëpërmjet ekspertit teknik nga lëmia e gjeodezisë, në vendin e ngjarjes ka konstatuar se parcela shtetërore e cekur më afër në dispozitiv të këtij aktvendimi, me kulturë është kullosë (djerrinë) ndërsa e tërë sipërfaqja e sajë është e lirë dhe nuk shfrytëzohet për kurrfarë qëllimi. Pas vërtetimit të gjendjes faktike në vendin e ngjarjes, eksperti teknik – gjometri ka kryer kufizimin dhe matjen e paluajtshmërisë së kërkuar, në bazë të së cilës është hartuar skica e terrenit dhe kopja e planit, në të cilën është pasqyruar kuarti, kufiri dhe sipërfaqja e cila mund të shfrytëzohet për qëllime të dedikuara.

Duke shqyrtuar kërkesën dhe shkresat tjera të lëndës, Kuvendi komunal ka konstatuar se kërkesa mund të aprovohet, nga arsyerat se në territorin e komunës së Rahovecit, nuk ekziston Fabrika për përpunimin e prodhimeve prej dheut. Arsyeja tjetër është se në bazë të dispozitave të nenit 14. dhe 39. të Ligjit mbi tokat ndërtimore, komuna tokën në pronësinë shoqërore (shtetërore) në të cilën ka të drejtë disponimi, mund t,i japi në shfrytëzim personave shoqëroro-juridik, shoqatave të qytetarëve dhe personave tjerë juridik, me qëllim të ndërtimit të objekteve për nevojat e tyre.

Nga arsyerat të cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

KËSHILLA JURIDIKE: Në procedurën administrative ky aktvendim është përfundimtar, kundër tij mund të hapet kontesti administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr.276/2009

Rahovec, më 2.07.2010



Kryesuesi
Kujtim Popaj

Rahovec
Data 16.08.2021

R A P O R T

I

Komisionit për vlerësimin e gjendjes faktike të parcelës nr.381 në vendin e quajtur " Kodra" në zonën Kadastrale Bellacërk, Komuna Rahovec

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 818, numri i faqes 246 të datës 03.08.2021 për formimin e "Komisionit për konstatimin e gjendjes faktike në parcelën nr.381 në vendin e quajtur " Kodra" me sipërfaqe prej 11.37,36 ha nga Çertifikata Nr.117 Z.K.Bellacërk, P.SH. e Kosovës me titullar K.K.Rahovec. "

Pas pranimit të vendimit me date 10.08.2021 komisioni në përbërjen e tij të plotë ka dalur në terren për të verifikuar gjendjen faktike të parcelës në fjalë.

Pas daljes në terren ku është vizituar e tërë sipërfaqja e parcelës me nr. 381 në vendin e quajtur Kodra në zonën kadastrale në Bellacërk, komisioni ka marrë foto nga terreni dhe ka vëzhguar me kujdes se a janë ndërmarrë veprime ndërtimore në ndonjë pjesë të caktuar të parcelës në fjalë.

Gjatë vizitës në terren Komisioni nuk ka vërejtur se janë ndërmarrë veprime ndërtimore për ndërtimin e çfarë do objekti apo edhe nuk ka mundur që të konstatojë se është bërë edhe ndonjë punë prapake rrethuese e punishtes apo punë tjetër ndërtimore, së paku në momentin e vizitës nuk mund të konstatohet pasi që në tërë sipërfaqen e parcelës vërehet vegjetacion I ulët dhe I mesëm I cili na jep indikacione se nuk janë ndërmarrë veprime ndërtimore në parcelën në fjalë.

Pjesë e këtij raporti janë fotot e marura në terren gjatë vizitës së komisionit.









Komisioni:

Sylejman Daka, Kryesues

Fidan Hoti, anëtar

Arben Gashi, anëtar

Bjondina Ramaj, anëtare

Diellza Çanta, anëtare

- Kryetari të Komunës